



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura IV**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 85

Prishtinë, më 8.7.2013, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S2

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

**Në mbledhje morën pjesë:** Arben Gashi, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu dhe Gëzim Kelmendi.

**Munguan:** Mufera Şinik dhe Jasmina Zhivković.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Hava Orana – Bota Sot, Armend Shkoza – LVV, Lumnije Murati – ZPRK, Blerta Bejtullahu – EUSR/EVO, Ilir Gashi – ZPRK, Lejla Selimi- OSBE, Donjetë Hoxha-Birn, Edona Peci – Kalkan Insight, Florent Spahija- BIRN Inter news, Teuta Gashi – Kosova Press, Bardhe Shkreli – RTK radio, Naim Jahaj – GP VV, Adonis Tahiri – VV, Vlora Marmullakaj – EULEX, Petrit Hysaj – OSBE, Erëlehta Popaj – Kosova Live, Sylë Ahmeti, Kosova Sot, Rebeka Maliqi dhe Fjolla Gashi - praktikantë

**Nga stafi i Komisionit për Legjislacion:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi,** Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 27.5 dhe 3.6. 2013;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti;
4. Shqyrtimi i kërkesës për interpretim të Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës;
5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime i Komisionit për buxhet dhe financa në Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale;
6. Shqyrtimi i propozim-amendamentit Kushtetues, propozuar nga deputeti Amir Ahmeti;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116;
8. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryetari** propozoi që pikë e rendit të ditës të jetë edhe shqyrtimi i Projektligjit për amnistinë.

**Albulena Haxhiu** - Tha se është kundër futjes në rend të ditës të projektligjit për amnisti, pasi që nuk i ka plotësuar kushtet procedurale, nuk është prezent ministri i Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, dhe jam kundër për shkak të përmbajtjes së tij.

**Kryetari** konstatoi se miratohet rendi ditës me ndryshimin e propozuar.

## 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 27.5 dhe 3.6. 2013

**Kryetari** konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 27.5 dhe 3.6. 2013, pa vërejtje.

## 3. Shqyrtimi i projektligjit për amnistinë

**Kryetari** - Tha se ky projektligj është i ri dhe dallon nga Projekti i kaluar dhe ka ardhur në procedurë të rregullt. Ai i njoftoi deputetët me përmbajtjen e tij dhe me ndryshimet që ka ky projektligj.

**Albulena Haxhiu** - Tha se përderisa Qeveria po kërkon me çdo kusht t'i amnistojë kriminelët serbë, mbrëmë u plagosën 6 qytetarë shqiptarë në fshatin Mitrovicë, në Podujevë! Për çfarë normalizimi të marrëdhënieve e keni fjalën? Po ashtu, ky projektligj shkon në dëm të të gjithë prodhuesve dhe bizneseve në Kosovë, në dëm të fitimit të munguar për shkak të kontrabandës të parapara me nenin 3 të këtij Projektligji.

Kështu siç është ky projektligj, e shkatërron gjithë sistemin gjyqësor të Kosovës, i cili edhe me heqjen e nenit 3 nuk është ndryshuar substancialisht. Pasi që Ivica Daçiqi u ndie i zhgënjyer me mos miratimin e Projektligjit të propozuar më parë, Qeveria e Kosovës bëri sikur e ndërroj ligjin, duke ju hedhur hi syve qytetarëve, shoqërisë civile dhe atyre deputetëve të ndërgjegjësohem që votuan kundër dhe tani na sjellë një Projektligj të njëjtë, por me një version tjetër. Ky Projektligj, kështu si na është sjellë, ka për qëllim amnistimin e krimit të organizuar dhe të kontrabandës. Nëse merrni dhe i analizoni ligjet e vendeve të Bashkimit Evropian e shohim se amnestimi konsiston në zvogëlimin e dënimit për personat që tashmë janë duke e vuajtur dënimin. Pra nuk ka ligji që i amnistion kriminelët nga ndjekja penale, ose ata që në një të ardhme mund të jenë objekt i hetimit. Ky lloj i amnistisë bëhet si pasojë e gjendjes së jashtëzakonshme, ku pushteti e njehë këtë situatë, sepse duke shpallur gjendjen e jashtëzakonshme krijohet edhe baza faktike për krijimin e një gjendje të veçantë juridike. Mirëpo, ne si shtet, asnjëherë nuk kemi shpallur një gjendje të jashtëzakonshme në një pjesë të caktuar të territorit të Kosovës, e as që kemi njohur ndonjë konflikt që ka pamundësuar ndjekjen penale personave që kanë qenë ndesh me ligjin. Pra Kosova është shtirur gjatë gjithë këtyre viteve se asgjë nuk ka ndodhur dhe formalisht ka konsideruar se e ka shtrirë sovranitetin në tërë territorin. Mos përcaktimi kohor i këtij Projektligji është problemi tjetër, sepse loja më e ultë që është duke u shtyrë përmes këtij ligji është përfshirja e veprave penale nga ligji penal i ish- Jugosllavisë. Ky projektligj është në favor të dy kategorive strukturave kriminale në veri dhe atyre që janë marrë me kontrabandë, pra të gjitha veprat që kanë të bëjnë me cenimin e rendit juridik janë përfshirë në këtë Projektligj.

Me këtë projektligj nuk shtrihet sovraniteti i Kosovës edhe në pjesën Veriore, por ai t'ju dorëzohet këtyre strukturave ilegale, andaj ju bëjë thirrje të mos e përkrahni këtë projektligj.

**Haki Demolli**- Tha se këtë projektligj e kemi diskutuar edhe në draftin e kaluar, edhe në seancë dhe në parim jemi për aprovimin e projektligjit. Mirëpo këtë e kemi kushtëzuar me tri kushte. E para kemi kërkuar heqjen e nenit 3, që i përkiste draftit të kaluar, e i cili tashmë është hequr me këtë draft. Kushti dytë që kemi kërkuar është që të mos amnistohet veprat penale kundër jetës dhe trupit që nënkupton vrasjet dhe plagosjeve të rënda, vërejtje kjo e realizuar në draftin e këtij projektligji në nenin 4 par. 1. 3. Dhe kushti i tretë ka qenë që krimet ekonomike të mos amnistohen zyrtarët publikë dhe shërbyesit civilë. Kjo kërkesë akoma nuk është trajtuar, por shpresojmë që edhe kjo do të merret parasysht. Me qëllim që të bëhet integrimi i qytetarëve të pjesës veriore të Kosovës, ne përkrahim në parim këtë projektligj, duke përjashtuar amnistinë për personat që kanë kryer veprat e lartcekura.

**Ardian Gjini** - Tha se është shumë keq që diskutimet në Komision po shndërrohen në deklarata për media dhe në këtë mënyrë po provohet të lajthitet opinioni publik. Ai tha se edhe pas miratimit të këtij projektligji, prokurorët do të kenë punë, sepse amnistia përfshin veprat deri më 20 qershor. Vetë kërkimi i amnistisë nga pala serbe në bisedime, tregon për rëndësinë e këtij procesi nëpër të cilin po kalon Kosova. Ky proces është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe nuk guxojmë të harrojmë që Kosova nuk ka qenë asnjëherë vetëm në proceset e saja.

**Arsim Bajrami**- Tha se ky projektligj duhet parë si një përpjekje për të vendosur rendin e ligjin në veri. Ky projektligj përmban një amnisti politike. Nuk është ligji më i mirë i mundshëm, mirëpo rrethanat në cilat gjendemi e arsyetojnë këtë projektligj. Mendoj se duhet të përkrahet projektligji, pasi që ka marrë edhe ndryshimet e duhura.

**Halit Krasniqi**- Tha se deri më tash Kosova nuk e ka pasur sovranitetin në tërë territorin e saj, kurse me këtë ligj Kosovën e bëjmë sovranë në gjithë territorin e saj. Po ashtu bëjmë edhe një marrëveshje me qytetarët serbë, të cilët me këtë amnisti e njohin shtetin e Kosovës. Por në rast se ata vazhdojnë të kryejnë vepra penale ata do t'i nënshtrohen ligjeve të Kosovës.

**Behar Selimi** - Tha se deputetët që kanë dhënë pëlqimin për projektligjin në parim, është fjala për Projektligjin e kaluar, i cili nuk është miratuar në seancë, e kanë votuar atë me shpresë se do të këtë ndryshime të tij më vonë. Kurse tani ato ndryshime, të pritura, i kemi në këtë draft që po e shqyrtojmë, dhe ripërsëriti qëndrimin e tij se në përfaqësimin e tij se na lejohet në mes të dy leximeve mund të bëjmë edhe ndryshimet nëse e vlerësojmë të nevojshme.

**Armend Zemaj**- Shprehu mendimin e tij se sjellja e këtij projektligji është rezultat i asaj që ka dalë nga seanca plenare, e cila nuk e votoi versionin e kaluar, pavarësisht premtimeve që do të këtë ndryshim. Unë personalisht, kam besuar se nuk do të ndodh ajo, duke pasur parasysht premtimet e rrejshme të Qeverisë që kanë ndodhur në të kaluarën. Në tërë kohën po flasim për veriun dhe po pranohet që projektligji është si rezultat i marrëveshjes politike, por pse edhe me ligj po tentohet t'i iket përgjegjësisë që ne të kemi një amnisti për atë pjesë të caktuar dhe për ato struktura paralele të cilat nuk kanë vepruar në kuadër të republikës së Kosovës, dhe si e tillë është amnisti politike. Unë kërkoj që të kemi vendosmëri, së pari Qeveria e Kosovës të sqarojë, pse ndodh amnistia politike dhe ne si deputetë ta kufizojmë për atë strukturë të caktuar dhe të përjashtohen nga amnistia njerëz që kanë kryer vepra penale në pjesë të tjera të Kosovës. Ky projektligj do të lë mundësinë që kriminelët ordinerë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, strukturat ilegale çfarëdo qofshin të subjekteve politike që të amnistohen, për këtë nuk kam ndonjë dyshim, shpresoj që ta kem gabim. Unë jam “për”, që amnistia duhet të bëhet për integrimin e vendit. Kjo është pranuar edhe nga subjekti im politik dhe nga miqtë ndërkombëtarë, por sanksionimi duhet të jetë përgjegjësia jonë si deputetë. Qeveria është dashtë ta marrë guximin dhe të thotë; kjo amnisti po bëhet për strukturat ilegale dhe pjesëtarët e tyre të komunitetit serb dhe nuk do të kishim asnjë dyshim. Por jam “kundër” të

amnistohen njerëz që i kanë ndenjët në qafë qytetarëve të Kosovës që 14 vjet. Jam që të sanksionohet koha, afati, rrethanat, njerëzit, strukturat dhe të jepet amnistia.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni me 6 vota “për” 1 votë kundër dhe 2 veta nuk morën pjesë në votim, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji nr. 04/L-209 për Amnistinë.

#### **4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti**

**Kryetari** vlerësoi se nenet 8.1.2, 8.2, dhe 12.2 të Projektligjit për skemat pensionale, nuk janë në pajtim me nenet 24.1 e 24.2, të Kushtetutës së Kosovës, me nenet 2. a, 4.1. h dhe 6.3, të Ligjit kundër diskriminimit dhe me nenin 1, të Protokollit 1, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Neni 24.1, i Kushtetutës së Kosovës përcakton se çdo kush e gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Po ashtu, edhe neni 24.2, ndër të tjera, përcakton se askush nuk mund të diskriminohet lidhur me të drejtën e pronës.

Ligji kundër diskriminimit në nenet 2. a, 4.1. h, e ka përcaktuar parimin e trajtimit të barabartë, pa diskriminim, ndaj personit në bazë të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike ose sociale, të pronës dhe bindjes politike etj. Po ashtu, neni 6.3, i këtij projektligji e ka përcaktuar obligimin e personave që ushtrojnë funksione publike, që me rastin e përpilimit të ndonjë dokumenti që paraqet rregullator juridik, të promovojnë dhe të respektojnë politikën e mos diskriminimit gjatë kohës së ekzekutimit të detyrimeve, që rrjedhin nga ai rregullator lidhur me ndonjë kontratë publike, hua, kontribut financiar ose përfitime të tjera.

Në anën tjetër, Protokollit 1, neni 1, i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e ka përcaktuar se çdo person fizik dhe juridik ka të drejtë që në mënyrë të papenguar ta shfrytëzojë pasurinë e vet. Po ashtu, ky kushtëzim u pamundëson familjeve të kontributdhënësve, shfrytëzimin e kontributeve pensionale në formën e pensionit familjar. Nenet e theksuara të projektligjit, janë në mospajtim me Ligjin kundër diskriminimit (nenet 2. a, 4.1. h dhe 6.3), sepse nuk e përmbajnë parimin e trajtimit të barabartë pa diskriminim, për shfrytëzimin e së drejtës në pronën e fituar, me dhënien e kontributit për sigurimin pensional, pa i plotësuar 15 vjet stazh, deri më 1 janar 1999 dhe paraqesin rregulla juridike, që nuk promovojnë dhe nuk e respektojnë politikën e mos diskriminimit, lidhur me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontributet financiare për sigurimin pensional. Dispozitat e Projektligjit të lartcekur, ua pamundësojnë kontributdhënësve shfrytëzimin e interesit pasuror, që rrjedh nga kontributet pensionale, të cilat në kuptim të nenit 1, të Protokollit 1, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, paraqesin pronën për kontributdhënësin dhe në këtë kuptim kontributdhënësit dhe çdo personi fizik dhe juridik, i garantohet e drejta që në mënyrë të papenguar ta shfrytëzojë pronën e vet.

*Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr. 04/L- 131 për skemat pensionale, të financuara nga shteti dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, me përjashtim të neneve 8.1.2, 8.2, dhe 12.2 të Projektligjit, e që nuk janë në pajtim me nenet 24.1 e 24.2 të Kushtetutës së Kosovës, me nenet 2. a, 4.1. h dhe 6.3, të Ligjit kundër diskriminimit dhe me nenin 1, të Protokollit 1, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.
2. Komisioni për Legjislacion, propozon amendamentet si vijon:

#### **Amendamenti 1**

Neni 8.1.2

**Të riformulohet si vijon:** Duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor nr. 011- 24/ 83 (Gazeta Zyrtare e KSAK, nr. 26/83) para datës 1.1 1999.

#### **Amendamenti 2**

Neni 8. 2

**Të riformulohet si vijon:** Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributdhënës, sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve, sipas strukturës kualifikuese dhe kriteret tjera, përcaktohen me akt nënligjor, të cilin do ta miratojë ministria përkatëse.

#### **Amendamenti 3**

Neni 12.2

Të riformulohet si vijon: Në rreshtin e katërt dhe të pestë të hiqen fjalët “për 15 vjet”, ndërkaq teksti tjetër të vazhdojë si në Projektligj.

#### **5. Shqyrtimi i kërkesës për interpretim të Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës;**

Komisioni e shqyrtoi kërkesën e Ahmet Krasniqit, për interpretim të nenit 25, paragrafi 1 dhe 3, dhe nenit 28.1, Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës nr. 03/L-229 dhe vlerëson se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e tij, ndonëse dispozitat e theksuara të ligjit nr. 03/L-229, për mbrojtjen e konkurrencës, e kanë qartësinë e duhur normative, andaj është e nevojshme të vepohet në pajtim me ligjin.

Po ashtu, u vlerësua së mënyra e adresimit të kërkesës, nga ushtruesi i detyrës, nuk është në pajtim me dispozitat e ligjit, sepse shkresa për interpretim do të duhej të dërgohet nga Komisioni i Konkurrencës, ngase vendimmarrja është përcaktuar me nenin 29, të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

*Komisioni për Legjislacion i rekomandon Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, që ta ftojë kryetarin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në një nga mbledhjet e radhës, që të raportojë lidhur me përbërjen aktuale të Komisionit, mandatin e ushtruesit të detyrës dhe anëtarëve të Komisionit.*

#### **6. Shqyrtimi i raportit me rekomandime i Komisionit për buxhet dhe financa në Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale,**

**Kryetari**, i njoftoi deputete se Komisioni për buxhet dhe financa ka propozuar disa amendamente për t'ju shmangur implikimeve buxhetore në nenet 76,212,213,214,221 dhe 228. Ai kërkoi deklarinimin e anëtarëve nëse i përkrahin amendamentet e propozuara.

*Meqë nuk kishte vërejtje kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime përkrahu amendamentet e propozuara nga Komisioni për buxhet dhe financa.*

#### **7. Shqyrtimi i propozim-amendamentit Kushtetues, propozuar nga deputeti Amir Ahmeti**

Komisioni e shqyrtoi kërkesën e deputetit Amir Ahmeti, lidhur me propozimin për amendamentin kushtetues, për ndryshimin e nenit 8 dhe vlerësoi se amendamenti i propozuar nuk ka bazë për procedim të mëtejshëm, ngase nuk është zbatuar procedura, siç përcaktohet me nenin 144 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

#### **8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116,**

**Kryetari** – Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamentet të Komisionit Funkcional, në Projektligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116, dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarojnë, nëse kanë vërejtje.

*Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:*

#### **P ë r f u n d i m**

1. Projektligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116, dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

E përgatiti:  
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

---

**Arben Gashi**